



# GSRM

## KOMISIONE TË APLIKUARA NGA NDËRMJETËSIT FINANCIAR

Material Infomues

## ***INFORMACIONI MBI KOMISIONET PËR VEPRIMET E BONOVE TË THESARIT QË APLIKOHEN NGA BANKA CREDINS***

1. Për blerje Bono Thesari në tregun primar (nëpërmjet pjesëmarrjes në ankand) komisioni është i barabartë me 0.2% të vlerës nominale të bonos (komisioni minimal është 2,000 lekë, ndersa komisioni maksimal është 5,000 lekë).

### ***Shembull:***

Një klient blen në tregun primar një Bono Thesari me vlerë nominale 1,200,000 lekë. Komisioni i aplikueshem në këtë rast është i barabartë me 2,400 lekë

$$1,200,000 * 0.2\% = 2,400 \text{ lekë}$$

2. Për blerjet e një bono Thesari nga banka para datës së maturimit, aplikohet një komision i barabartë me 1% të çmimit të blerjes së bonos.

### ***Shembull:***

Një klient kërkon të shesë një Bono Thesari me vlerë nominale 1,000,000 lekë, që maturohet pas 170 ditësh. Kuotimi BID (%) është 7.35%.

Çmimi i blerjes llogaritet si më poshtë:

$$\text{Çmimi i Blerjes} = 1,000,000 / (1 + 0.0735 * 170 / 365) = 966,900 \text{ lekë}$$

Komisioni llogaritet si më poshtë:

$$\text{Komisioni} = 966,900 * 1\% = 9,669 \text{ lekë}$$

3. Për shitjet e bonove të Thesarit nga portofoli i bankës, aplikohet një komision i barabartë me 1% të çmimit të shitjes së bonos.

### ***Shembull:***

Një klient kërkon të blejë një Bono Thesari nga portofoli i bankës Credins. Bono e Thesarit ka vlerë nominale 1,000,000 lekë dhe maturohet pas 360 ditësh. Kuotimi ASK(%) është 8.05%.

Çmimi i shitjes llogaritet si më poshtë:

$$\text{Çmimi i Shitjes} = 1,000,000 / (1 + 0.0805 * 360 / 365) = 926,443 \text{ lekë}$$

Komisioni llogaritet si më poshtë:

$$\text{Komisioni} = 926,443 * 1\% = 9,264 \text{ lekë}$$